21158

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr.21158 Akt.

VENDIM

PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, me daten 08.04.99, Tirane Gëzuela Copo, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga drejtori i shoqerise se kontrolluar "ALBPETROL"SHA per regjistrimin e saj si shoqeri tregtare "ALBPETROL" SHA Fier

KONSTATOVA:

Kerkuesi, shoqeria "ALBPETROL" SHA, ka paraqitur kerkesen per t'u regjistruar si person juridik, ne formen e nje shoqerie anonime pa oferte publike, te krijuar mbi bazen e ristrukturimit te ish shoqerise "ALBPETROL" sipas Vendimit te Keshillit Ministrave nr.756 date 26.11.1998, me kohezgjatje pa afat te caktuar, me aksioner te vetem shoqerine kontrolluese "APC" SHA Tirane, me kapital themeltar 6 211 086 000 leke, i ndare ne 6 211 086 aksione , me vlere nominale secili prej 1 000 leke, me objekt veprimtarie kerkimin, zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve, me seli ne qytetin e Patosit te rrethit Fier.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti dhe kerkesa per regjistrimin e shoqerise tregtare anonime si person juridik jane te plota , te bazuara ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe nenit 33 te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA:

Regjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "ALBPETROL" SHA Patos Fier,me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 6 211 086 000 leke, me aksioner te vetem shoqerine kontrolluese "APC"SHA Tirane, me vlere nominale te aksionit 1 000 leke dhe me objekt veprimtarie kerkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.

Antaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

1. Stavri Dhima
2. Qani Hoxha
3. Vlash Laçka
4. Gjergj Kosta
5. Gjergji Foto
6. Artur Gjerazi
7. Maksi Dhimitri
8. Gazmend Kadiu
9. Aleksander Moçi

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

Ermila Copo

URDHER REGJISTRIMI

Me

1. 21.158

2.a. "Alpetrol" SH.A.

b. Tregtimi, blerjemi, prodhimi ndërkombëtar

c. 6211086000 leke.

c. Selim Rrotani e Fatmir Ktos.

3. Asamblejë
Këshilli Mbikqyrës
Drejtorët

4. Statuti nënshkruar me date 06.04.99

5. Data e regjistrimit 08.04.99.

Statuti 9 Fletë

Njoftime: a. shoqëria

b. dhomën e tregtisë

c. organit përkatës financiar

d. zyrës së statistikës

Publikime:

GJYQTARE

AKT THEMELIMI

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregtare", shoqeria "APC"SHA Tirane ka vendosur:

Neni 1
Te themelohet shoqeria "ALBPETROL"SHA, me statusin e shoqerise anonime pa oferte publike. Shoqeria "ALBPETROL" SHA eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria anonime "APC" Tirane.

Neni2
Shoqeria themelohet per te vepruar ne gjithe teritorin e vendit per nje afat te pacaktuar. Ajo e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 3
Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Patosit ne rrethin e Fierit.

Neni 4
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte kerkimi zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve.
Shoqeria do te zhvilloje dhe çdo aktivitet tjeter te mundshem e te ligjshem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6 211 086 000 leke. Ai eshte i ndare ne 6 211 086 aksione, secili me vlere nominale 1 000 leke.

Neni 6
Aksionet e shoqerise se kontrolluar "ALBPETROL" SHA zoterohen ne masen 100% nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane.

Neni 7
Organet drejtuese te shoqerise jane
Asambleja
Keshilli Mbikqyres
Drejtoria

Dispozita te hollesishme per funksionimin e tyre percaktohen ne statut.

Neni 8

Marredheniet ekonomike e financiare te shoqerise "ALBPETROL" SHA me shoqerine kontrolluese "APC" Tirane, si dhe marredheniet e shoqerise "ALBPETROL" SHA me shoqerite e tjera te kontrolluara nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane, rregullohen me marreveshje ndermjet paleve, marreveshje qe miratohen nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise "APC" Tirane.

Neni 9

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise percaktohen ne statut.

Neni 10

Data e fillimit te veprimtarise se shoqerise do te konsiderohet 01.04.1999.

SHOQERIA "APC" SHA Tirane

Me autorizim te Ministrit Ekonomise Publike e Privatizimit

DREJTORI PERGJITHSHEM

KASTRIOT BEJTAJ

Tirane me ... ...

STATUTI

I SHOQERISE "ALBPETROL" SHA

Ne baze te ligjit nr.7638 Date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe mbeshtetur ne aktin e themelimit , shoqeria "APC" SHA Tirane, nxjerr kete statut me kushtet e meposhteme

KREU I
Emertimi, selia, afati

Neni 1
Eshte themeluar shoqeria anonime pa oferte publike me emertimin "ALBPETROL" SHA. Shoqeria eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria "APC"SHA Tirane

Neni 2
Shoqeria krijohet per te vepruar ne gjithe territorin e vendit per nje afat te pacaktuar

Neni 3
Shoqeria ka seline e saj ne qytetin e Patosit ne rrethin e Fierit. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 4
Ne veprimtarine e saj shoqeria zbaton legjislacionin shqipar, normat e percaktuara ne aktin e themelimit dhe ne kete statut.

KREU II
Objekti i veprimtarise

Neni 5
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte kerkimi, zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve.
Shoqeria do te zhvilloje dhe çdo aktivitet tjeter te mundshem e te ligjshem ne perputhje me interesat e saj.

Neni 6
Realizimi i objektit te veprimtarise do te behet nepermjet shfrytezimit te zonave nafte e gazmbajtese qe shoqerise i jane dhene ne perdorim si dhe shfrytezimi i rerave bituminoze.

Neni 7
Ne lidhje me objektin e veprimtarise shoqeria trashegon dhe merr mbi vete te gjitha te drejtat e detyrimet qe shoqeria e meparshme "Albpetrol" SHA ka patur nga marreveshjet e hidrokarbure qe lidhen me kerkimin zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve.

KREU III
Kapitali themeltar

Neni 7
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6 211 086 000 000 Leke
Ai eshte i ndare ne 6 211 086 aksione te se njejtes kategori, secili me vlere nominale 1 000 leke.

Neni 8
Kapitali themeltar perbehet nga kontribute ne para dhe kontribute ne natyre dhe eshte i shlyer teresisht.

Neni 9
Aksionet e shoqerise zoterohen ne masen 100% nga shoqeria kontrolluese "APC SHA Tirane

Neni 10
Transferimi i aksioneve tek te tretet behet konform legjislacionit ne fuqi per privatizimin e prones shteterore.

KREU IV
Organet drejtuese

Neni 11
Organet drejtuese te shoqerise jane:
Asambleja
Keshilli Mbikqyres
Drejtoria

Neni 13
Asambleja e shoqerise se kontrolluar eshte shoqeria kontrolluese "APC"SHA Tirane.

Neni 14
Asambleja eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ajo thirret jo me rralle se nje here ne vit. Mbledhjet e saj zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne rendin e dites.

Neni 15
Te drejten per thirrjen e mbledhjes se Asamblese e kane:
Keshilli Mbikqyres
Drejtoria
Ekspertet kontabel te autorizuar

Neni 16
Ne çdo rast drejtoria e shoqerise eshte pergjegjese per pergatitjen dhe mbarevajtjen e mbledhjeve te Asamblese.

Neni 17
Ne mbledhjet e Asamblese mbahet proçesverbal. Rendi i dites i Asamblese duhet te permbaje percaktimin e mbledhjes si e zakonshem apo e jashtezakonshme, çeshtjet qe do te shqyrtohen, daten, oren dhe vendin e mbledhjes.

Neni 18
Ne mbledhjen e Asamblese marrin pjese, pa te drejte vote, antaret e Keshillit Mbikqyres, te drejtorise dhe ekspertet kontabel.

Neni 19
Asambleja ne mbledhjet e saj merr vendime. Vendimet e Asamblese nenshkruhen nga kryesuesi i saj. Ato jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga Keshilli Mbikqyres e Drejtoria.

Neni 20
Kompetencat e Asamblese se jashtezakonshme jane ato qe percaktohen ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Neni 21

Asambleja e zakonshme miraton:

1. Programin e zhvillimit te shoqerise;
2. Bilancin financiar, llogarite dhe inventaret vjetore;
3. Raportin vjetor te administrimit.

Ajo emeron dhe shkarkon antaret e Keshillit Mbikqyres dhe rekomandon strukturen organizative, numrin maksimal te personelit drejtues e teknik si dhe raportet e pagave te punonjesve te shoqerise..

Neni 22

Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga 9 Anetare. Ata jane persona fizike dhe nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri e as anetare te drejtorise se saj. Antaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne Keshillat mbikqyres apo ne drejtorite e shoqerive te tjera te kontrolluara nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA.

Neni 23

Antaret e Keshillit Mbikqyres u nenshtrohen te gjitha perjashtimeve te percaktuara me ligj apo akte nenligjore lidhur me funksionin e tyre.
Kohezgjatja e mandatit te antarit te Keshillit Mbikqyres eshte 4 vjet. Kur vendi i nje antari te Keshillit mbetet bosh per çfaredo arsye, Asambleja, brenda 3 muajve nga data e njoftimit duhet te beje zevendesimin. Anetari i zgjedhur ne kete rast mbaron mandatin e anetarit te zevendesuar.
Kur mbete bosh vendi i kryetarit te Keshillit, paavaresisht nga zgjedhja e anetarit te ri proçedohet edhe per zgjedhjen e Kryetarit sipas dispozitave te percaktuara ne kete statut.

Neni 24

Anetarte e Keshillit zgjedhin nga radhet e tyre nje kryetar dhe nje zevendeskryetar, qe ngarkohen me mbledhjen e Keshillit dhe drejtimin e diskutimeve.

Neni 25

Keshilli Mbikqyres mblidhet te pakten çdo tre muaj, por ai mund te mblidhet edhe sa here qe e kerkojne interesat e shoqerise.
Mbledhja e Keshillit Mbikqyres thirret nga Kryetari e ne mungese te tij nga zevendeskryetari.
Mbledhja e Keshillit Mbikqyres mund te kerkohet edhe nga 1/3 e anetareve te Keshillit apo nga drejtoria e shoqerise. Ne kete rast kryetari e ne mungese te tij zv/kryetari jane te detyruar te therrasin Keshillin brenda 15 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses.

Neni 26

Lajmerimi per mbledhjen e Keshillit Mbikqyres behet minimumi 3 dite me pare me leter , telegram, teleks ose fax. Ajo mund te behet edhe me goje apo pa afat kur nje gje e tille pranohet nga te gjithe anetaret e tij. Lajmerimi duhet te permbaje kurdohere rendin e dites dhe vendin, daten e oren e mbledhjes.

Neni 27

Mbledhja e Keshillit Mbikqyres konsiderohet e vlefshem kur ne te marrin pjese me shume se ½ e anetareve te tij me perjashtim te mbledhjes per emerimin e shkarkimin e antareve te drejtorise ne te cilen duhet te jene te pranishem jo me pak se 2/3 e antareve.

Anetaret e Keshillit nuk mund te perfaqesohen ne mbledhjet e tij.

Vendimet ne mbledhjen e Keshilit merren me shumicen e thjeshte te votave te anetareve te pranishem. Ne rast votash te berabarta, vota e kryetarit eshte percaktuese.

Per çeshtje urgjente, me kerkesen e argumentuar te drejtorise Keshilli Mbikqyres mund te marre edhe vendime qarkulluese kur per to firmosin rregullisht jo me pak se 2/3 e anetareve te Keshillit.

Neni 28

Keshilli Mbikqyres mban nje regjister te pjesmarrjes se anetareve ne mbledhjet e tij. Lista e pjesmarrjes per çdo mbledhje nenshkruhet nga anetaret e pranishem. Mungesa ne mbledhje per me shume se tre here radhazi, pa shkaqe te arsyeshme, sjell shkarkimin nga detyra.

Per diskutimet dhe vendimet e Keshillit mbahet proçesverbali cili nenshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe te pakten 2 anetare te tjere te pranishem.

Neni 29

Vendimet e Keshillit Mbikqyres nenshkruhen nga Kryetari ose, ne mungese te tij ne mbledhjen e Keshillit, nga zevendeskryetari.

Vendimet e marra rregullisht nga Keshilli Mbikqyres jane te detyrueshem per zbatim nga ana e Drejtorise.

Neni 30

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria.

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ai i çmon te pershtatshme dhe kerkon te njihet me dokumentat qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjn e detyres se tij.

Keshilli Mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

Neni 31

Keshilli Mbikqyres ka ne kompetence:

Emerimin e antareve te drejtorise, percaktimin e kompetencave te tyre si dhe pagen e çdo anetari te drejtorise.;

Miratimin e raporteve periodike 3 mujore te administrimit te shoqerise nga ana e drejtorise;

Miratimin e struktures organizative te shoqerise dhe kriteret e percaktimit te pages se punonjesve.

Miratimin e hapjes, mbylljes, shkrirjes, bashkimit ose ndarjes se veprimtarive apo njesive te reja nga ana e shoqerise, brenda objektit te veprimtarise se saj;

Miratimin e dhenies se dorzanise ose garancive te tjera, kur keto te fundit tejkalojne veprimtarine e zakonshme te shoqerise me kusht qe dorzanite e garancite te mos kene objekt pasuri te patundshme te shoqerise;

Miratimin e lidhjes se çdo kontrate qe i takon veprimtarise se zakonshme por qe eshte me afat me shume se 1 vit si dhe te marrveshjeve qe lidhen me permiresimin e zhvillimin e pasurive te patundshme dhe qe nuk i perkasin marredhenieve ndermjet shoqerive te kontrolluara nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane;

Miratimin e projektmarreveshjeve me kompanite e tjera te kontrolluara,

Miratimine rregullores se veprimtarise se shoqerise

Neni 32

Keshilli Mbikqyres verifikon, llogarite vjetore, bilancin financiar dhe inventaret e hartuara nga drejtoria dhe i paraqet Asamblese raportin e tij se bashku me raportin per administrimin vjetor te shoqerise nga ana e drejtorise.

Neni 33

Keshili Mbikqyres mund te zgjedhe nje sekretar edhe jashte radheve te tij. Ai mund te miratoje rregullore per menyren e funksionimit te tij.

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres behet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kete problem.

Neni 34

Anetare te pare te Keshillit Mbikqyres jane:

1. Stavri Dhima
2. Qani Hoxha
3. Vlash Laçka
4. Gjergj Kosta

5. Gjergji Foto
6. Artur Gjerazi
7. Maksi Dhimitri
8. Gazmend Kadiu
9. Aleksander Moçi

Neni 35

Veprimtaria e zakonshme e shoqerise drejtohet nga drejtoria. Ajo perbehet nga 3 anetare nga te cilet njeri emerohet drejtor i pergjithshem. Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe 4 vjeçare, me te drejte riemerimi.
Anetaret e drejtorise nuk mund te jene mbi moshen 60 vjeç.

Neni 36

Anetaret e drejtorise nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres. Ne rastin kur nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet anetar i drejtorise ai duhet te japë, qe nga dita e emerimit, doreheqje nga detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres.
Anetari i drejtorise nuk mund te jete anetar i nje drejtorie tjeter te shoqerive te kontrolluara por as dhe te shoqerive te tjera tregtare.

Neni 37

Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen ne çdo kohe nga Keshilli Mbikqyres vetem per shkaqe te arsyetuara qe lidhen me veprimtarine e shoqerise.

Neni 38

Drejtoria ka te gjitha kompetencat per te ushtruar veprimtarine e zakonshme te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me vendimet e Asamblese e ato te Keshillit Mbikqyres.

Neni 39

Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet.
Keshilli Mbikqyres percakton kompetencat e çdo anetari te drejtorise.

Neni 40

Drejtoria pergjigjet per administrimin e shoqerise para Asamblese dhe Keshillit Mbikqyres. Ajo, nenpergjegjesine e saj paraqet çdo tre muaj ne Keshillin Mbikqyres raport te hollesishem te veprimtarise se shoqerise. Ajo eshte e detyruar t'u japë organeve drejtuese çdo informacion, çdo te dhene apo dokument qe keto te fundit e konsiderojne te vlefshem per kryerjen e detyrave te tyre.

KREU V
Kontrolli financiar dhe viti ushtrimor

Neni 41

Kontrolli financiar ushtrohet nga eksperte kontabel te autorizuar qe emerohen nga Asambleja dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.
Eksperte te pare kontabel te autorizuar emerohen 1.Z. Baki Berberi 2. Z. Njazi Laze 3. Z. Fatos Haxhiraj dhe 4. Z. Kastriot Haxhaj.

Neni 42

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbarn me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Ben perjashtim viti i fillimit te veprimtarise ne te cilin si date e fillimit te ushtrimit financiar do te konsiderohet data 01.04.1999.

Neni 43

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.
Ne mbyllje te ushtrimit, drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.
Drejtoria pergatit gjithashtu raportin e administrimit vjetor te shoqerise ne te cilin duhet te evidentohet gjendja e shoqerise gjate ushtrimit financiar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet qe kane ndodhur si dhe veprimtarite per te ardhmen.

Neni 44

Ne shpenzimet e shoqerise per vitin ushtrimor do te perfshihet dhe kostua e kontrollit e menaxhimit e shoqerise kontrolluese sipas percaktimit ne aktin e themelimit.

Neni 45

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave e shpenzimeve te ushtrimi.
Nga fitimet e ushtrimit, kur eshte rasti, hiqet te pakten 5% per te krijuar rezerven ligjore te domosdoshme. Heqja e kesaj rezerve nuk eshte e detyrueshme kur ajo arrin 1/10 e kapitalit themeltar.
Nga fitimet e ushtrimit, kur eshte rasti, hiqen fondi per krijimin e rezerves per zhvillim. Sasia e ketij fondi percaktohet ne programin e zhvillimit per çdo vit nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane.

Shuma e fitimeve te mbetura, pas zbritjeve te mesiperme, perfaqesojne dividentin, i cili derdhet ne llogarine e shoqerise kontrolluese "APC" SHA Tirane.

KREU VI
Dispozita te fundit

Neni 46
Shoqeria e mbyll veprimtarine e saj me vendim te Asamblese ose kur jane rastet e parashikuara ne ligj.
Ne çdo rast te mbylljes se veprimtarise emerohen, ne perputhje me dispozitat ligjore, likujdatore.
Te ardhurat qe mbeten mbas mbylljes se veprimtarise se shoqerise i perkasin shoqerise kontrolluese "APC" SHA Tirane.

Neni 47
Per çdo gje qe nuk eshte shprehur posaçerisht ne kete statut i referohet legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

SHOQERIA "APC" SHA

Me autorizim te Ministrit Ekonomise Publike dhe Privatizimit

DREJTORI PERGJITHSHEM

KASTRIOT BEJTAJ

Tirane me... ... ...

REPUBLIKA E SHQIPERISE ALBANIAN PETROLEUM CORPORATION SH.A APC TIRANE